



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 52
Prishtinë, më 9 mars 2012

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 9 MARS 2012**

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 80 deputetë.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Debat parlamentar për Ditën Ndërkombëtare të Gruas

1. Debat parlamentar për Ditën Ndërkombëtare të Gruas

Kryetari, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, ftoi kryetaren e Grupit të Grave Deputete, Teuta Sahatqija, që ta prezantojë dhe arsyetojë kërkesën për debat.

Teuta Sahatqija, në emër të Grupit të Grave Deputete, tha se grupi që ajo drejton ka kërkuar një seancë të veçantë parlamentare për pozitën e femrës në Republikën e Kosovës dhe presim që në fund të debatit t'i nxjerrim rekomandimet konkrete.

Në vazhdim ajo sqaroi se nënshkrues të kërkesës për debat janë deputetë nga të gjitha grupet parlamentare, së këndejmi pritet që diskutimet të jenë gjithëpërfshirëse.

Më tej, ajo u fokusua në sfidat me të cilat ballafaqohen femrat në Kosovë, me theks të veçantë në problemet që ato kanë për qasje në drejtësi, në faktorë të natyrës ekonomike, arsimore, etj. Deputetja Teuta Sahatqija, më pas vuri në pah plagët e shumta në trup dhe në shpirt, që kanë përjetuar gratë, sidomos gjatë periudhës së luftës në Kosovë. Ajo foli edhe për çështjen e grave

të dhunuara gjatë luftës në Kosovë, nga ana e pushtuesit serb, për të cilën çështje tha se është problem shumëdimensional, ndërsa zgjidhjen duhet kërkuar në aspektin institucional.

Duke folur për pozitën aktuale të femrës në shoqërinë kosovare, ajo vlerësoi se në këtë drejtim ka edhe të arritura konkrete, për të konstatuar se Grupi i Grave Deputete, angazhohet që femra kosovare të bëhet femër, siç tha ajo, me zë, ndërsa për shoqërinë prioritet të jetë çështja e barazisë gjinore.

Në fund ajo i paraqiti rekomandimet e propozuara, për të cilat tha se në fund të debatit do t'i harmonizojmë përfundimisht me të gjitha grupet parlamentare, varësisht nga rrjedha e debatit dhe i ftoi deputetët për miratim të tyre.

Suzan Novoberdaliu, në emër të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, tha se përkrahim kërkesën për një debat të tillë në Kuvendin e Kosovës dhe se kjo paraqet një kaptinë të re edhe për jetën parlamentare.

Në vazhdim ajo tha se të drejtat e gruas kudo në botë kanë qenë një sfidë e vjetër sa edhe vetë njerëzimi, ndërsa ligjet në fuqi për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të gruas, jo gjithherë janë zbatuar në shoqëri.

Deputetja Suzan Novoberdaliu, më pas u fokusua në aspekte të tjera të çështjes, për të theksuar në mënyrë të veçantë faktin që një vend përmes ndërtimit të politikave shtetërore në këtë fushë, determinon përcaktimin dhe përkushtimin ndaj përmirësimit të vazhdueshëm të pozitës së gruas në një shoqëri.

Në fund ajo përkrahu miratimin e rekomandimeve nga Kuvendi.

Blerta Deliu-Kodra, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha mes tjerash se kriteri i barazisë gjinore paraqet një element të rëndësishëm për rritjen e kapaciteteve integruese të Republikës së Kosovës, në raport me BE-në.

Ajo më pas u fokusua në arritjet e femrës kosovare në shoqëri, duke e ilustruar këtë me zgjedhjen e presidentes së Kosovës, zgjedhjen e dy zëvendëskryeministreve dhe të një ministreje në Qeverinë aktuale.

Deputetja Blerta Deliu-Kodra, më pas vuri në pah disa statistika që flasin për barazinë gjinore në vend, duke theksuar se Kosova në këtë aspekt në nivel rajonal rangohet ndër vendet e para, ndërsa në nivel botëror e shtatëmbëdhjeta.

Më pas foli edhe për përmirësimin e bazës ligjore në vend që është krijuar me nxjerrjen e Ligjit të punës dhe ligjeve tjera që kanë të bëjnë me këtë fushë.

Në fund ajo përkrahu debatin e sotëm dhe inkurajoi institucionet për zbatimin e kriterit të barazisë gjinore.

Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së tha se mbështesim kërkesën e Grupit të Grave Deputete, për një debat në Kuvend.

Në vazhdim tha se të drejtat e grave janë fundament për zhvillimin e një shoqërie dhe nga ky këndvështrim ajo duhet parë si vlerë.

Më tej ai u fokusua në arritjen e standardeve sa më të larta që shoqëria jonë duhet të synojë për çështjen e barazisë gjinore.

Edhe pse janë shënuar arritje në këtë drejtim, akoma kemi punë për të bërë, sidomos në zbatimin e kriteve të barazisë gjinore në nivel të pushtetit lokal si dhe në nivel të bordeve të ndryshme, konstatoi deputeti Ismet Beqiri.

Në fund ai përkrahu rekomandimet e paraqitura nga propozuesi i debatit dhe i ftoi deputetët për miratim.

Alma Lama, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, fillimisht vuri në pah protestën e një dite më parë, të mbajtur në Prishtinë, në lidhje me dhunën e ushtruar nga Serbia ndaj grave të dhunuara në Kosovë, gjatë luftës.

Në vazhdim ajo tha se kjo temë deri më tani në Kosovë ka qenë temë tabu. Ato heshtin sepse shoqëria deri më tani nuk u ndihmoi, nëse edhe ne heshtim për to, zëri i tyre do të heshtet përgjithmonë, nënvizoi deputetja Alma Lama.

Për një krim të tillë ndaj grave të dhunuara në Kosovë, nga ana e Serbisë, deri më tani askush nuk është dënuar, theksoi ajo.

Më pas ajo shtroi nevojën që Kuvendi i Republikës së Kosovës të njohë kontributin e femrës gjatë luftës në Kosovë, ndërsa Qeveria e Republikës së Kosovës t'i përfshijë kategorinë e grave të dhunuara në listën e veteranëve të luftës.

Në fund ajo përkrahu rekomandimet e paraqitura për këtë debat.

Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se duke mos harruar historinë e dhimbshme të kaluar, të shkaktuar nga Serbia, gjatë luftës në Kosovë, fokusi i shoqërisë sonë duhet orientuar në krijimin e mirëfilltë të arritjes së standardeve për barazi gjinore.

Duke vlerësuar arritjet e deritashme nga kjo fushë, deputeti Ahmet Isufi tha se në të ardhmen duhet bërë akoma më tepër në këtë drejtim, duke vërë theksin në zbatimin e plotë të Ligjit të punës dhe ligjeve tjera nga kjo fushë.

Më tej ai theksoi edhe çështjen e mungesës së monumenteve për femrat luftëtare, duke e ilustruar këtë çështje me mungesën e monumentit për Xhevë Lladrovcin, Hanumshahe Abdullahun e shumë e shumë monumente të tjera.

Në fund ai përkrahu rekomandimet e paraqitura për këtë debat.

Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, tha se përkrahin debatin lidhur me këtë çështje dhe rekomandimet e paraqitura.

Në vazhdim ajo u fokusua në çështjet ligjore të cilat kanë të bëjnë me barazinë gjinore, zbatimin e tyre në praktikë, për të konstatuar se Ligji për barazi gjinore parasheh që 40% e femrave të jenë në vendimmarrje.

Në lidhje me çështjen e femrave të dhunuara gjatë luftës në Kosovë, nga ana e shtetit serb, ajo potencoi se kjo çështje duhet të rregullohet në mënyrë ligjore.

Myfera Shinik, emër të Grupit Parlamentar “6+”, fillimisht foli për rëndësinë e Ditës Ndërkombëtare të Gruas-8 marsit.

Më tej ajo shtroi nevojën e një trajtimi akoma më adekuat që femra në përgjithësi duhet ta ketë në shoqërinë tonë, si në aspektin ekonomik, të punësimit, shkollimit dhe zbatimin më të mirë të ligjeve në fuqi që kanë të bëjnë me barazinë gjinore.

Në fund ai përkrahu rekomandimet e paraqitura për këtë debat.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë deputetët: Sabri Hamiti, Halit Krasniqi, Time Kadrijaj, Emilija Rexhepi, Agim Kuleta, Teuta Haxhiu, Jakup Krasniqi, Donika Kadaj-Bujupi, Lirije Kajtazi, Xhevahire Izmaqu, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Albulena Haxhiu, Nazane Breca, Jeton Svirca, Valbona Dibra, Vjollca Osmani, Aurora Bakalli, Sala Berisha-Shala, Rita Hajzeraj-Beqaj, Gëzim Kelmendi dhe Afrim Kasolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim fjalën e mori në emër të Grupit të Grave Deputete, Teuta Sahatqija e cila tha se në ndërkohë i kemi analizuar rekomandimet e dhëna gjatë debatit, dhe të njëjtat i kemi harmonizuar bashkë me përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare, me rekomandimet e paraqitura në fillim të këtij debati.

Më pas ajo i paraqiti para deputetëve tetë rekomandimet e harmonizuara.

Lidhur me harmonizimin e rekomandimeve diskutuan edhe: kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, si dhe deputetët: Hykmete Bajrami dhe Flora Brovina, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari në vazhdim hodhi në votim rekomandimet e harmonizuara të paraqitura nga propozuesi i debatit.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 54,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, miratoi këto

REKOMANDIME

1. Trajtim i veçantë institucional i grave të dhunuara gjatë luftës. Gjithashtu i bëjmë thirrje drejtësisë vendore e ndërkombëtare t'i dënojë kryerësit e këtyre krimeve që paraqesin elemente të krimit e të gjenocidit;
2. Të hartohen politikat që fuqizojnë ekonomikisht gratë dhe favorizojnë iniciativat e grave në biznes. Ministria e Integritetit Evropian të ndërmarrë veprime konkrete për të përfituar fondet strukturale të BE-së, të cilat do të shfrytëzoheshin për gratë: në ndërmarrësi, afarizëm, bujqësi, artizanat dhe shkencë;
3. Në universitete të zhvillohen kurrikulet në favor të politikave gjinore, në veçanti politikave që përgatisin gratë për veprimtari ekonomike. Po ashtu, të rishikohen tekstet mësimore në të gjitha nivelet dhe të pastrohen nga të gjitha stereotipet negative për gratë;
4. Të zbatohen në tërësi dispozitat kushtetuese, ligjore dhe konventat ndërkombëtare për përfaqësimin e barabartë të grave në diplomaci;
5. Të respektohet Ligji për barazinë gjinore në bordet e ndërmarrjeve publike;
6. Të zbatohet në tërësi strategjia kundër dhunës në familje dhe të ndëshkohen me dënime serioze ushtruesit e dhunës;
7. Të zbatohet në tërësi Ligji i punës. Në veçanti të ndërmerren veprime konkrete nga Inspektorati i Punës dhe
8. Të zbatohen në tërësi dispozitat kushtetuese, ligjore dhe ato që dalin nga obligimet ndërkombëtare, për trajtimin e barabartë të gruas në shoqëri.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 14 : 55 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale